



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR
REGJISTRIMIN DHE VEPRIMTARINË E AGJENTIT TË LIDHUR TË SHOQËRISË
KOMISIONERE**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 188, datë 16.12.2020
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr.119, datë 25.07.2025*

**Neni 1
Qëllimi i rregullores**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i formës dhe përmbajtjes së kërkesës për regjistrimin e agjentit të lidhur të shoqërisë komisionere, të përmbajtjes së dokumentacionit dhe procedurës për regjistrimin e kërkesës për agjentin e lidhur, të detyrimeve të shoqërisë komisionere, si dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së agjentit të lidhur.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 22, pika 4, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

**Neni 3
Përkufizime**

1. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Agjent i lidhur” është personi juridik, i cili, nën përgjegjësinë e plotë dhe pa kushte të vetëm një shoqërie komisionere në emër të së cilës vepron, promovon shërbime investimi dhe/ose shërbime ndihmëse për klientë ekzistues ose klientë të mundshëm.

“Platformë e administruar nga shoqëria komisionere” është një website ose program kompjuterik me një ndërfaqe grafike që përdoret për të tregtuar tituj dhe instrumente financiare nëpërmjet një rrjeti elektronik të komunikimit mes bursave, sistemeve alternative të tregtimit, dhe që është nën administrimin e një shoqërie komisionere.

“Funksionar kryesor” është administratori i agjentit të lidhur.

2. Të gjitha përkufizimet e tjera të kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, referuar në këtë rregullore si “Ligji”.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për agjentin e lidhur që kryen veprimtarinë e promovimit të shërbimeve të investimit në emër dhe nën përgjegjësinë e plotë të një shoqërie komisionere të licencuar në:
 - a) Republikën e Shqipërisë
 - b) Një nga vendet e Bashkimit Evropian
2. Për efekt të kësaj rregulloreje, agjenti i lidhur mund të kryejë veprimtari për klientët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo klientët e vendeve ku shoqëria komisionere është e autorizuar të ushtrojë aktivitet, sipas licencës përkatëse.

Neni 5

Veprimtaria e promovimit

Veprimtaria e agjentit për promovimin e shërbimeve të investimit dhe/ose shërbimeve ndihmëse të shoqërisë komisionere konsiston në kryerjen e të paktën një prej veprimeve të mëposhtme:

- a) Promovimi, nëpërmjet komunikimin me klientët ekzistues ose klientët e mundshëm, i shërbimeve dhe instrumenteve financiare që ofron shoqëria komisionere, në emër të së cilës vepron;
- b) Komunikimi me klientët ekzistues dhe/ose klientët e mundshëm për ofrimin e informacioneve në lidhje me shërbimet dhe instrumentet financiare të shoqërisë

komisionere, si dhe informacioneve që kanë ose do kenë ndikim në tregjet dhe instrumentet financiare, sipas orientimit të shoqërisë komisionere.

Neni 6

Formë-kërkesa

1. Çdo person juridik që kërkon të bëhet agjent i lidhur i një shoqërie komisionere të licencuar depoziton kërkesën për regjistrim pranë Autoritetit.
2. Kërkesa për regjistrimin e agjentit bëhet sipas aneksit 1 të kësaj rregulloreje shoqëruar nga dokumentacioni i kërkuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje.
3. Aneksi 1 plotësohet në format elektronik dhe dorëzohet i printuar në format A4 në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa korrigjime.

Neni 7

Dokumentacioni për regjistrimin e agjentit

1. Formë - kërkesa për regjistrimin e agjentit shoqërohet nga dokumentacioni që dëshmon plotësimin e kriterëve të aftësisë dhe të përshtatshmërisë në përputhje me nenin 13 të Ligjit dhe të listuara në pikën 2 të këtij neni.
2. Dokumentacioni që shoqëron formë-kërkesën është si më poshtë:
 - a) Statuti i shoqërisë;
 - b) Ekstrakti i regjistrimit të shoqërisë në QKB;
 - c) Kontrata / letra e angazhimit të agjentit me shoqërinë komisionere, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë;
 - d) Licenca e shoqërisë komisionere, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë, lëshuar nga Autoriteti përkatës;
 - e) Informacionin në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:
 - i. Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;
 - ii. Të dhënat e parashikuara në shkronjën i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.
 - f) Dokument i lëshuar nga organet kompetente për aksionarët/ortakët, administratorin/funksionarin kryesor të shoqërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës/administrimit (kjo e fundit në rastin e shoqërive aksionare), si më poshtë:
 - i. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;

- ii. Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;
 - iii. Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;
 - iv. Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera;
 - v. Dokument për gjendjen e detyrimeve tatimore;
- g) Deklaratë personale e nënshkruar nga aksionarët/ortakët, administratori/funksionari kryesor i shoqërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës/administrimit (kjo e fundit në rastin e shoqërive aksionare) se:
- i. Nuk është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose
 - ii. Nuk ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;
 - iii. Nuk është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.
- gj) CV, diploma, kualifikime, trajnime për aksionarët/ortakët, administratorin e shoqërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës/administrimit (kjo e fundit në rastin e shoqërive aksionare);
- h) Rregullat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 10 të kësaj rregulloreje;
- i) Informacion për punonjësit, që do promovojnë shërbimet dhe instrumentet financiare të shoqërisë komisionere, në lidhje me integritetin e tyre sipas përcaktimit të nenit 13 të Ligjit, si dhe për njohuritë, kualifikimin dhe përvojën e tyre;
- j) Dokument që vërteton se zotëron kapitalin e kërkuar sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje.
3. Dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 2 gërma f paragrafi (i), (ii) dhe (iii) të këtij neni, synon të vërtetojë nëse personi është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krimit ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, si dhe pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.
4. Shoqëria e agjentit mban përgjegjësi për punësimin e punonjësve promovues me integritetin, kualifikimin dhe përvojën e nevojshme në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

5. Agjenti i lidhur ka detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Agjenti i lidhur depoziton në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individi mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.

Neni 8 **Kërkesa për kapital**

Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit duhet të ketë një kapital jo më të vogël se 6,000,000 lekë.

Neni 9 **Rregullat e brendshme të veprimtarisë së agjentit**

1. Çdo person juridik ushtron veprimtarinë e agjentit të lidhur në mbështetje të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen me shoqërinë komisionere, të kërkesave të Ligjit dhe kërkesave rregullatore.
2. Veprimtaria e agjentit të lidhur, gjithashtu, kryhet mbi bazën e rregullave të brendshme, ku përfshihen:
 - a) Mënyrat e promovimit të shërbimeve;
 - b) Mënyra e komunikimit dhe monitorimit të punonjësve gjatë komunikimit me klientët;
 - c) Procedurat e njohjes së klientëve, rregullat e parandalimit të pastrimit të parave, dhe mënyra e shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave të klientëve, kur është parashikuar në marrëveshjen me shoqërinë komisionere;
 - d) Rregulla dhe politika mbi shpërblimin, vlerësimin e performancës, përshkallëzimin e masave në rastin e shkeljeve nga punonjësit në marrëdhëniet me klientët, si dhe politika për shmangien e konfliktit të interesit.

Neni 10 **Kërkesat mbi organizimin e veprimtarisë**

1. Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit duhet të punësojë punonjës me kualifikimin dhe përvojën e duhur në ofrimin e shërbimeve për klientët.

2. Shoqëria, në mënyrë të vazhdueshme, duhet të sigurojë që punonjësit e saj vazhdojnë të posedojnë kualifikime të duhura nëpërmjet kryerjes së trajnimeve të vazhdueshme.
3. Në rast se një punonjës nuk posedon njohuritë dhe kompetencat e nevojshme, punonjësi mund të ofrojë shërbimet përkatëse vetëm nën mbikëqyrje dhe për një periudhë të kufizuar kohore.
4. Shoqëria (agjenti) duhet të përcaktojë qartë rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve dhe të sigurojë që ata dinë, kuptojnë dhe zbatojnë politikat dhe procedurat e brendshme të shoqërisë.
5. Agjenti duhet të sigurojë që shpërblimi i punonjësve të mos krijojë konflikte interesi si pasojë e promovimit të shërbimeve dhe instrumenteve financiare të shoqërisë komisionere për të cilin vepron.
6. Agjenti duhet të sigurojë që punonjësit përdorin emrin e tyre të vërtetë dhe të mos japin informacione të rreme në lidhje me kredencialet e tyre përfshirë vendndodhjen kur komunikojnë me klientët.
7. Agjenti duhet të përdorë një format standard për pyetjet dhe përgjigjet më të shpeshta, duke deklaruar informacionin që mund të ndahet me klientët, e cila jepet nga shoqëria komisionere.
8. Agjenti duhet të sigurojë që praktikat e tilla si: thirrjet telefonike të shpeshta dhe të përsëritura dhe / ose përdorimi i gjuhës agresive dhe / ose ushtrimi i presionit, duke i kërkuar / këshilluar klientin të investojë dhe / ose të depozitojë fonde, nuk duhet të ndodhin.
9. Agjenti duhet të ketë procedurat / kontrollet e duhura për vlerësimin e performancës së stafit si dhe të marrë masa ndëshkuese në rastet kur vlerësimi është i dobët ose negativ dhe/ose kur gjykohet se veprimet e një punonjësi të veçantë janë në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi.
10. Në rastet kur punonjësi është larguar për një shkelje serioze të kërkesave rregullatore, informacioni i një largimi të tillë (së bashku me të gjitha faktet përkatëse) duhet të referohet pranë AMF, si dhe të referohet pranë organeve të tjera ligjzbatuese për shkelje të mundshme penale.
11. Agjenti vendos procedura/sisteme për monitorimin e vazhdueshëm ndaj të gjitha komunikimeve të punonjësve me klientët si dhe siguron që të verë në dispozicion të Autoritetit, sa herë që kërkohet, telefonatat e regjistruara.

Neni 11

Nevoja për njohuri dhe kompetencë

Agjenti duhet të sigurojë që punonjësit kanë njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për të kuptuar:

- a) Karakteristikat kryesore, rrezikun dhe tiparet e produkteve të investimit që promovohen, duke përfshirë çdo implikim të përgjithshëm në anën fiskale dhe kostot që do të duhet të përballojë klienti në lidhje me transaksionet;
- b) Llojin e tarifave, komisioneve dhe koston totale që do të ketë klienti gjatë kryerjes së transaksionit për instrumentin financiar, shërbimin e investimit apo shërbimin ndihmës që po ofrohet;
- c) Karakteristikat dhe qëllimin e shërbimeve të investimeve, si dhe të platformave që administrohen nga shoqëria komisionere;
- d) Dhe për të patur kujdes në dhënien e informacionit në lidhje me instrumentet financiare që karakterizohen nga nivele më të larta të kompleksitetit;
- e) Se si funksionojnë tregjet financiare dhe si ato ndikojnë në vlerën dhe çmimet e produkteve të investimit për të cilat u ofrohet informacion klientëve;
- f) Ndikimin e të dhënave ekonomike, ngjarjeve kombëtare / rajonale / globale në tregjet financiare dhe në vlerën e instrumenteve financiare, për të cilat ata japin informacion;
- g) Dallimin e performancës së kaluar dhe skenarëve të ardhshëm të performancës, si dhe kufizimet e parashikimeve;
- h) Çështjet që lidhen me abuzimin e tregut dhe pastrimin e parave;
- i) Dhe për të vlerësuar të dhënat përkatëse për instrumentet financiare dhe shërbimet e investimit, për të cilat ai jep informacion, si dhe dokumentet kryesore të informacionit për investitorin, prospektet, pasqyrat financiare ose të dhëna të tjera financiare;
- j) Strukturat specifike të tregut për instrumentet financiare, në të cilat ato ofrojnë informacion për klientët;
- k) Dhe patur njohuri themelore të parimeve të vlerësimit për llojin e instrumentit financiar, në lidhje me të cilat jepet informacioni.

Neni 12

Trajnimi

1. Niveli i kualifikimit dhe përvojës së duhur për punonjësit e agjentit që promovojnë shërbimet për klientët përcaktohet nga shoqëria komisionere në bazë të kërkesave rregullatore të vendit ku është licencuar shoqëria komisionere.

2. Niveli i kualifikimit sigurohet nëpërmjet trajnimit të punonjësve që promovojnë shërbimet nëpërmjet një nga mënyrat:
 - a) Organizimit të trajnimeve nga shoqëria komisionere;
 - b) Organizimit të trajnimeve nga shoqëria e agjentit;
 - c) Ofrimit të trajnimeve nga qendra të specializuara të njohura.
3. Shoqëria e agjentit mund të konsiderojë kualifikimin e punonjësve edhe si kombinimin i mënyrave të mësipërme, e orientuar nga shoqëria komisionere.

Neni 13

Shqyrtimi i aplikimit dhe afati i regjistrimit të agjentit të lidhur

1. Autoriteti, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe listën e dokumenteve të depozituara për regjistrim të agjentit të lidhur sipas kërkesave të Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti, nëse vëren se kërkesa e dorëzuar nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, i kërkon subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike, që brenda 10 (dhjetë) ditëve pune të plotësojë kërkesën duke specifikuar dokumentet që mungojnë.
3. Nëse subjekti për arsye të argumentuara nuk është në gjendje të paraqesë ndonjë nga dokumentet brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditë pune, Autoriteti kur e shikon të arsyeshme mund të zgjasë afatin edhe me 10 (dhjetë) ditë pune të tjera. Nëse subjekti kërkues nuk dorëzon dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, Autoriteti refuzon kërkesën si të pa plotë dhe njofton subjektin kërkues për refuzimin e kërkesës, duke dhënë argumentet përkatëse.
- 3/1. Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kritereve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.
4. Brenda 2 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga subjekti kërkues, Autoriteti njofton subjektin mbi regjistrimin apo refuzimin e kërkesës për regjistrim për veprimtarinë e agjentit të lidhur të shoqërisë komisionere.
5. Në rastin kur agjenti vepron në emër të një shoqërie komisionere të licencuar nga një autoritet i huaj rregullator, Autoriteti komunikon, kur e shikon të arsyeshme, me autoritetin rregullator të vendit të origjinës të shoqërisë së huaj komisionere.

Neni 14

Vendimi i regjistrimit të agjentit të lidhur

1. Regjistrimi i agjentit të lidhur bëhet me vendim të Bordit të Autoritetit.
2. Në vendimin e regjistrimit, Autoriteti përcakton, nëse e gjykon të arsyeshme, kushte ose kufizimeve në veprimtarinë e agjentit.
3. Autoriteti refuzon kërkesën për regjistrim nëse nuk plotësohen kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje.
4. Agjenti depoziton, brenda një muaji nga data e vendimit të regjistrimit, kontratën e nënshkruar me shoqërinë komisionere.
5. Në rast të mosplotësimit të kërkesës së pikës 4 të këtij neni, Autoriteti nuk e regjistron agjentin në regjistrin publik.
6. Veprimtaria e agjentit fillon me regjistrimin në regjistrin publik.
7. Regjistrimi i agjentit të lidhur shoqërohet me pagesën e tarifës për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 15

Mbikëqyrja e agjentit të lidhur

1. Çdo person, i cili regjistrohet në cilësinë e agjentit të lidhur, është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga Autoriteti.
2. Agjenti duhet të veprojë në çdo kohë në përputhshmëri me detyrimet e përcaktuara në ligj dhe në këtë rregullore.
3. Shoqëria (agjenti), e cila:
 - a) Shkel ndonjë nga kërkesat e ligjit dhe/ose të kësaj rregulloreje,
 - b) Shkel ndonjë prej kushteve ose kufizimeve të vendosura për regjistrim,
 - c) I ka dhënë Autoritetit informacione të rreme, të pasakta ose mashtruese, është subjekt i parashikimeve të nenit 30 të ligjit.

Neni 16
Detyrimi për raportim i agjentit

1. Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit të lidhur, brenda muajit mars të çdo viti, depoziton në Autoritet pasqyrat financiare vjetore dhe raport të plotë mbi veprimtarinë dhe mënyrën e respektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Agjenti dhe shoqëria e agjentit, raporton çdo 3-muaj në Autoritet mbi veprimtarinë e kryer, sipas formatit të aneksit 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 17
Ruajtja e kërkesave dhe njoftimi i ndryshimeve

1. Kërkesat për regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në këtë rregullore duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë nga agjenti.
2. Subjekti njofton me shkrim Autoritetin për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është kryer regjistrimi.
3. Njoftimi depozitohet në Autoritet menjëherë me regjistrimin e ndryshimeve në QKB.
4. Njoftimi në Autoritet shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje.

Neni 18
Detyrimet e shoqërisë komisionere ndaj agjentit të lidhur

1. Shoqëria komisionere detyrohet të:
 - a) Monitorojë veprimtarinë e agjentit të lidhur në mënyrë që të sigurojë se agjenti zbaton dispozitat e ligjit dhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit;
 - b) Sigurohet se agjenti i lidhur, kur kontakton ose hyn në marrëdhënie me çdo klient aktual ose të mundshëm, jep informacion për cilësinë me të cilën vepron dhe për shoqërinë komisionere që përfaqëson;
 - c) Merr masat e përshtatshme për të shmangur çdo ndikim negativ që mund të ketë veprimtaria e agjentit të lidhur.

2. Shoqëria komisionere është përgjegjëse për veprimtarinë e agjentit në zbatim të Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
3. Shoqëria komisionere, që për çfarëdo lloj arsye zgjidh ose ndërpret marrëdhënien me agjentin e lidhur, njofton pa vonesë Autoritetin dhe i jep arsyet përkatëse për ndërprerjen e marrëdhënies.

Neni 19

Vlefshmëria e regjistrimit të veprimtarisë së agjentit

1. Vlefshmëria e regjistrimit të veprimtarisë së agjentit nga Autoriteti është e lidhur me afatin e vlefshmërisë së kontratës me shoqërinë komisionere për llogari të së cilës punon.
2. Në çdo rast të ndryshimit të kushteve të kontratës, agjenti depoziton në Autoritet kontratën e ndryshuar me shoqërinë komisionere.
3. Në rast të mbylljes së kontratës me një shoqëri brokerimi dhe nënshkrimit të një kontrate me një shoqëri tjetër brokerimi, agjenti njofton Autoritetin dhe depoziton kontratën e re, si dhe licencën e shoqërisë së brokerimit në titujt, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë.
4. Në rast të konstatimit të ndonjë mangësie apo shkeljeje, Autoriteti njofton subjektin, ose merr masa në përputhje me nenin 16 të kësaj rregulloreje.

Neni 20

Dispozita kalimtare

1. Të gjitha subjektet, e njohura për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shoqërisë të licencuar të brokerimit në përputhje me Ligjin nr. 9879 datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe Rregulloren nr.71 datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në titujt” vijojnë veprimtarinë në përputhje me njohjen përkatëse.

2. Të gjitha subjektet, e njohura për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit duhet të depozitojnë në Autoritet një raport të detajuar për përshtatshmërinë me kërkesat e Ligjit 62/2020 dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Raporti i përshtatshmërisë depozitohet në Autoritet, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në ligj.
4. Autoriteti shqyrton raportin e përshtatshmërisë dhe në rast të mosplotësimit të kërkesave ligjore dhe rregullative, çregjistron subjektin për veprimtarinë e agjentit të lidhur.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

ANEKSI 1

FORMË KËRKESA PËR REGJITRIMIN E AGJENTIT TË LIDHUR TË SHOQËRISË KOMISIONERE

(Kjo formë-kërkesë plotësohet dhe nënshkruhet nga personi që kërkon të regjistrohet në cilësinë e agjenti të lidhur)

Kërkesë për regjistrim pranë Autoritetit

Drejtuar: Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Lënda: Kërkesë për Regjistrimin e Agjentit të Lidhur

Të nderuar Znj/Z,

Në mbështetje të nenit 22 të Ligjit “Për Tregjet e Kapitalit” si dhe rregullores së Autoritetit “Për Regjistrimin dhe veprimtarinë e Agjentit të Lidhur”, ju paraqes kërkesën për regjistrim në cilësinë e Agjentit të Lidhur.

Bashkëngjitur kësaj kërkesë gjeni dokumentacionin sipas kërkesave të Ligjit “Për Tregjet e Kapitalit” dhe kërkesave rregullatore.

INFORMACIONI PËR SUBJEKTIN KËRKUES

Të dhëna për Agjentin e Lidhur	Plotësoni informacionin
Emri i subjektit kërkues	
Forma juridike e subjektit kërkues	
Keni qenë subjekt kërkues më parë i regjistruar me emër tjetër (Po/Jo)	
Të dhëna mbi subjektin	
Data e Regjistrimit ne QKB	
Numri i identifikimit të subjektit (NUIS)	
Selia Qendrore	
E-Mail:	
Tel:	
Fax	
Adresa e faqes zyrtare të internetit, nëse është e aplikueshme	
Specifikoni të dhënat për çdo punonjës që do promovojë shërbimet e investimit të shoqërisë komisionere	
Emër Mbiemër:	
Datëlindja/Vendlindja	
Numri Personal i kartës së Identitetit apo pasaportës	
Kualifikimet	
Gjendja gjyqësore	
Emër Mbiemër:	
Datëlindja/Vendlindja	
Numri Personal i kartës së Identitetit apo pasaportës	

Kualifikimet	
Gjendja gjyqësore	
Emër Mbiemër:	
Datëlindja/Vendlindja	
Numri Personal i kartës së Identitetit apo pasaportës	
Kualifikimet	
Gjendja gjyqësore	

Të dhëna mbi shoqërinë komisionere	
Emri i shoqërisë	
Selia Qendrore /adresa	
Autoriteti licencues/të dhëna për licencën	
Website:	
Tel/Fax:	
E-mail	
Përfaqësuesi Ligjor i Shoqërisë Komisionere	
Të dhëna mbi kryerjen e veprimtarisë promovuese	
Vendndodhja e klientëve që do kontaktohen	
Emërtimi i platformës së shoqërisë komisionere	

Emër/Mbiemër	
Pozicioni	
Data	
Firma	

DEKLARATË

Unë i nënshkruari, vërtetoj se:

Jam në dijeni se është vepër penale dhënia me dashje Autoritetit të informacionit të rremë, çorientues ose mashtrues;

Jam në dijeni se kjo kërkesë do të refuzohet nëse nuk kemi dhënë informacionin e kërkuar nga Ligji Për Tregjet e Kapitalit dhe kërkesat rregullatore;

Konfirmoj që informacioni i dhënë në këtë aplikim është i saktë dhe i plotë për atë që jam në dijeni dhe do të njoftoj menjëherë Autoritetin nëse ka një ndryshim të rëndësishëm në informacionin e dhënë;

Jam në dijeni që Autoriteti mund të bëjë kërkime dhe të kërkojë informacione të mëtejshme kur e gjykon si të përshtatshme për të identifikuar dhe verifikuar informacionet që i konsideron të rëndësishme për vlerësimin e këtij aplikimi;

Konfirmoj se Agjenti i lidhur do të kryejë veprimtari promovuese vetëm për llogari shoqërisë komisionere [Emri i Shoqërisë];

Konfirmoj se Agjenti i lidhur nuk do të pranojë para dhe/ose instrumente financiare nga klientët ekzistues ose të mundshëm të shoqërisë komisionere;

Jam i vetëdijshëm se Autoriteti mund të ndërmarrë kontrolle me autoritete të tjera rregullatore në lidhje me personat të cilëve u referohet ky aplikim;

Kam bashkëngjitur këtij aplikimi dokumentet përkatëse sipas kërkesave rregullatore;

Jam në dijeni të detyrimit për të paguar tarifën e aplikimit dhe regjistrimit të kërkesës;

Konfirmoj se jam i autorizuar të nënshkruaj këtë deklaratë në emër të kërkuarit;

Konfirmoj se individët e specifikuar në këtë kërkesë janë të vetëdijshëm se për qëllime të përputhjes me Ligjin Nr. 9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të dhënat personale mund të përdoren nga Autoriteti për të përmbushur detyrimet e tij ligjore dhe në përputhje me atë Ligj, dhe këto të dhëna nuk do të përdoren për qëllime të tjera pa lejen e individit përkatës;

Jam i vetëdijshëm që pas regjistrimit, shoqëria jonë ka përgjegjësi të informojë Autoritetin dhe të raportojë mbi veprimtarinë e agjentit sipas kërkesave ligjore dhe rregullative;

Jam i vetëdijshëm se përgjegjësia për saktësinë e informacionit, si dhe dhënia e informacionit përkatës, në këtë aplikim është përgjegjësi e atij që nënshkruan aplikimin.

Emër/Mbiemër	
Pozicioni	
Data	
Firma	

ANEKSI 2

**FORMULAR RAPORTIMI
 MBI
 VEPRIMTARINË E AGJENTIT TË LIDHUR TË SHOQËRISË KOMISIONERE**

Emri i shoqërisë: XXXX

Periudha raportuese:

1. TE DHËNA MBI SHOQËRINË

A	Statusi i shoqërisë së agjentit	
1	NIPT	
2	Adresa kryesore (selia qendrore)	
3	Kodi postar	
4	Cel/Tel/Fax	
5	E-mail	
6	Website	

B	Administratori dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës / këshillit të administrimit		
	Emër / Mbiemër	Data e emërimit	Nr. kontakti / e-mail
1			
2			
3			
4			
5			

C	Të dhëna financiare	
1	Emri i shoqërisë audituese, e cila ka audituar raportet financiare më të fundit	
2	Emrat e bankave me të cilat operon shoqëria	
3	Shuma e kapitalit aksionar	
4	Aksionarët e shoqërisë	

D	Të dhëna për punonjësit që komunikojnë me klientët				
		Periudha e mëparshme	Shtesa	Pakësime	Periudha raportuese
1	Nr. i të punësuarve që promovojnë produktet financiare				

2	Nr. total i punonjësve				
3	Nr. i personave që kanë marrë trajnimin e plotë				
4	Nr. total i personave të trajnuar në vijimësi				

2. TË DHËNA MBI VEPRIMTARINË E AGJENTIT

A	Të dhëna për shoqërinë komisionere	
1	Emri i shoqërisë	
2	Nr. i licencës	
3	Data e lëshimit të licencës	
4	Adresa	
5	Autoriteti Mbikëqyrës	

B	Veprimtaria e agjentit të lidhur	
1	Vendndodhja e investitorëve që kontaktohen	
2	Emërtimi i platformës, administruar nga shoqëria komisionere	

C	Të dhëna për investitorët në territorin e Republikës së Shqipërisë	
1	Nr. i investitorëve individual	
2	Nr. i investitorëve institucionalë	

D	Aktiviteti i investitorëve në territorin e Republikës së Shqipërisë	
1	Shuma e depozituar (ekuivalenti në lekë)	(për periudhën raportuese)
2	Shuma e tregtuar (ekuivalenti në lekë)	(për periudhën raportuese)
3	Nr. i transaksioneve të realizuara	(për periudhën raportuese)

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Data e plotësimit

Shënime:

1. Ky formular plotësohet çdo 3-muaj. Agjenti i lidhur detyrohet që të dorëzojë në AMF formularin e plotësuar brenda datës 5 të muajit pasardhës, sipas periudhave respektive.
2. Shoqëria jep informacion për punonjësit e rinj që promovojnë shërbimet e investimit, sipas kërkesave të rregullores.
3. Ky formular shoqërohet edhe nga Deklarata, sipas formatit-tip më poshtë.

DEKLARATË – TIP

Shoqëria e agjentit [Emri i shoqërisë]

Shoqëria komisionere në emër të së cilës punon agjenti [Emri i shoqërisë]

Në cilësinë e administratorit/kryetarit të këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit të shoqërisë [Emri i shoqërisë] deklaroj se:

Për aq sa kam dijeni dhe besim:

1. Kontrata me shoqërinë komisionere [Emri i shoqërisë] është e vlefshme deri në datën.....;
2. Kryejmë aktivitetet vetëm për investitorët e vendeve ku shoqëria komisionere është e autorizuar për të ushtruar aktivitetet, sipas licencës përkatëse;
3. Administratori i shoqërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit, si dhe punonjësit që promovojnë produktet dhe shërbimet e shoqërisë komisionere dhe komunikojnë me klientët nuk janë të dënuar për ndonjë veprë penale dhe nuk kanë çështje penale në proces;
4. Niveli dhe mjaftueshmëria e njohurive të punonjësve që promovojnë produktet dhe shërbimet e shoqërisë komisionere janë në përputhje me kërkesat e shoqërisë komisionere, duke reflektuar qëllimin dhe shkallën e shërbimeve që ofron kjo shoqëri;
5. Të gjithë punonjësit që promovojnë produktet dhe shërbimet e shoqërisë së komisionere vazhdojnë të posedojnë kualifikime të duhura nëpërmjet kryerjes së trajnimeve të vazhdueshme;
6. Gjatë komunikimit me klientët, punonjësit përdorin emrin e tyre të vërtetë dhe nuk japin informacione të rreme në lidhje me kredencialet e tyre përfshirë vendndodhjen nga ku komunikojnë;
7. Monitorojmë në vazhdimësi komunikimin e punonjësve me klientët duke mos lejuar thirrje telefonike të shpeshta dhe të përsëritura, si dhe duke mos lejuar përdorimin e gjuhës agresive apo ushtrimin e presionit, duke i kërkuar klientit të investojë fondet.

Jam i ndërgjegjshëm se çdo deklaram i pasaktë dhe fshehje e fakteve do të jetë shkak dhe objekt i sanksioneve ligjore.

Deklaruesi (Emër, Mbiemër, Firmë)

Data e nënshkrimit